



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE**

**PËR ARSIMIN E ORIENTUAR**

**(ARTISTIK)**

**DEGA: KOREOGRAFI**

**LËNDA:**

**“HISTORI BALETI”  
(PROVIM ME ZGJEDHJE)**

**VITI SHKOLLOR 2021 – 2022**

**KOORDINATORE: MAJLINDA HALA**

## **PËRMBAJTJA**

PËRMBAJTJA.....	2
HYRJE .....	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	5
STRUKTURA E TESTIT.....	6
TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË.....	13

## HYRJE

Historia e baletit është një nga lëndët e kurrikulës artistike në arsimin e mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega “Koreografi“, integron njohuritë, shkathësitë, qëndrimet dhe vlerat nëpërmjet lëndëve: *Histori baleti shqiptar, Folklor koreografik dhe Histori baleti botëror*. Ajo ndihmon në zhvillimin e njohurive artistike që u shërbejnë nxënësve në aspektin personal, social dhe artistik.

Mësimi i mjaft lëndëve teorike artistike në këtë degë, iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e njohurive dhe të proceseve të zhvillimit të kërcimit në periudha të ndryshme të historisë së njerëzimit, të praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e kërcimit, të kontributit të arteve në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Programi orientues për provimin me zgjedhje histori baleti, përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të zhvillimit të historisë së baletit për shkollën e mesme artistike të sistemit 3 – vjeçar.

Ky program orientues për vitin shkollor 2021-2022, përbën një dokument të vlefshëm për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë së baletit, që do të përgatisin maturanët për provimin histori së baleti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore* që duhet të zotërojnë ata për të përballuar me sukses provimin histori baleti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar*, që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së baletit, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Programi orientues për provimin me zgjedhje histori baleti, synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë, duke u mbështetur në lëndët: *histori baleti*

*shqiptar, folklor koreografik dhe histori baleti botëror*, si dhe duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënës.

Programi duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara, ku një kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së baletit, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore. **Ata nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Vëmendje të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit.**

Materiali burimor mbi të cilin duhet të punojnë nxënësit, janë leksionet që ata kanë marrë nga mësuesit e tyre apo të gjitha burimet që ata kanë përdorur gjatë viteve për shqyrtimin e përmbajtjeve mësimore, të tilla si: leksione, tekste të përdorura që kanë të bëjnë me historinë e baletit shqiptar, historinë e baletit botëror dhe folklorit koreografik.

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për përgatitjen e provimit të lëndës së historisë së baletit me zgjedhje është mbështetur në:

- Programin e lëndës folklor koreografik, klasa e 10- të;
- Programin e lëndës histori baleti shqiptar, klasa e 10- të;
- Programin e lëndës histori baleti botëror klasa e 11- të dhe 12 - të.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban *strukturën e testit* në të cilën jepen tematikat si dhe pesha e tyre. Programi përmban rubrikën *e rezultateve të të nxënit* ku përcaktohen konceptet dhe aftësitë kryesore për çdo tematikë të lëndës së folklorit koreografik, histori baleti shqiptar dhe histori baleti botëror 10-12.

## STRUKTURA E TESTIT

Një nga aspektet më të rëndësishme në zhvillimin e vetëdijes artistike janë lëndët formuese dhe teorike të degës koreografi. Këto njohuri e ndihmojnë nxënësin në jetën profesionale dhe artistike. Përbushja e kompetencave artistike që një nxënës duhet të zotërojë në fund të shkollimit, arrihet nëpërmjet tematikave integruese të marra nga lëndët: *Folklor koreografik, Histori baleti shqiptar dhe Histori baleti botëror*. Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale** të lëndës në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënit që duhet të demonstrojë nxënësi në përbushjen e kompetencave artistike. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje. Në përgatitjen për përbushjen e këtij programi orientues do të përdoren programet e lëndës së folklorit koreografik, historisë së baletit shqiptar dhe historisë së baletit botëror për klasat 10-12.

Nr.	Tematikat	Pesha	Përmbajtja sipas tematikave
1.	<b>FOLKLORI KOREOGRAFIK</b>	<b>10%</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarja etno – koreografike</li> <li>- Tematikat specifike të fushave që përmbajnë gjininë lirike në koreografi</li> <li>- Karakteri i valles lirike shqiptare</li> <li>- Strukturat e ndërtimit arkitektonik të valles lirike shqiptare</li> <li>- Format e kërcimit popullor</li> <li>- Specifikat e shoqërimit muzikor në valle</li> </ul> </li>   <li>• <b>Epika në koreografi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Karakteristikat e epikës në koreografi</li> <li>- Vallet e rënda</li> <li>- Vallet dyshe dhe treshe</li> </ul> </li> </ul>

2.	<b>HISTORIA BALETIT SHQIPTAR</b>	20 %	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Baleti në gjysmën e parë të shekullit XX</b></li> <li>- Grupet e para amatore koreografike dhe veprimtaria artistike</li> <li>- Krijimi i Filarmonisë dhe veprimtaria artistike</li>   <li>• <b>Krijimi i Teatrit të Operas dhe Baletit</b></li> <li>- Jeta dhe krijimtaria artistike e Skënder Selimit dhe baletet Sheherezade, Fadeta dhe Laurencia</li> <li>- Jeta dhe krijimtaria e Panajot Kanaçit dhe baleti i parë Halili dhe Hajria</li> <li>- Grupi i të 5-ve. Artistë dhe themeluesit e shkollës së baletit</li> <li>- Jeta dhe veprimtaria e Agron Aliajt. baleti Cuca e maleve dhe baletet e tjera kombëtare</li> <li>- Krijimi i T.O.B dhe A.K.V.P</li> <li>- Gëzim Kaceli dhe krijimtaria e tij si pjesë e fondit të artë të A.K.V.P.</li>   <li>- Veprimtaria artistike e Agron Aliajt mbas viteve '90</li> <li>- Baleti mbas viteve '90</li> <li>- Angelin Preljocaj.</li> <li>- Baleti i Kosovës.</li> <li>- Yjet e baletit shqiptar të njohur në skenat ndërkombëtare</li> </ul>
----	--	------	--

3.	<b>HISTORIA BALETIT BOTËROR</b>	<b>E 70 %</b>	<p><b>Kërcimi në lashtësi dhe antikitet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet materiale, elementet dhe parimet themelore të kërcimit</li> <li>• Kërcimi në Egjiptin e lashtë dhe në Orientin e largët</li> <li>• Llojet e kërcimit në Greqinë dhe Romën Antike</li> </ul> <p><b>Mesjeta dhe llojet e kërcimeve;</b></p> <p><b>Rilindja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rilindja Europiane dhe kërcimi. Humanizmi.</li> <li>• Studimi mbi kërcimin, struktura dhe teoria</li> <li>• Kërcimi i oborrit.</li> <li>• Kërcimet e ulëta dhe të larta</li> <li>• Llojet e kërcimeve</li> <li>• Kërcimtarët e oborrit</li> <li>• Kërcimi në Francë</li> <li>• Kërcimi në Spanjë dhe Itali</li> <li>• Kërcimi social në Europë</li> <li>• në vitin 1500.</li> <li>• Kërcimi social në Itali</li> <li>• Kërcimi social në Francë</li> <li>• Ballot dhe baleti në traktatin Karozos dhe Negrit.</li> <li>• Komedia del Arte.</li> <li>• Artistët e Komedia del Arte</li> <li>• Lindja e baletit në oborrin Italian.</li> <li>• Baleti në oborrin Francez.</li> <li>• Baleti i parë. Baltazar.</li> </ul>
----	---	---------------	---



			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Balet i maskave dh antimaskave në Angli.</li> <li>• Koreografët dhe teoricienët e epokës.</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Shekulli XVII</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Repertori koreografik dhe muzikor në vitet e para të shekullit të XVII</li> <li>• Kërcimi dhe gjesti në melodramat e fillimeve të viteve 1600. Baleti Melodramatik.</li> <li>• Baleti i oborrit në Francë.</li> <li>• Baleti Maskarade dhe Melodramatik.</li> <li>• Baleti dhe kërcimi aristokrat në oborrin e Mbretit të Diellit.</li> <li>• Epoka e Luli dhe Molier</li> <li>• Krijimi i Akademisë mbretërore të kërcimit dhe lindja e koreografisë.</li> <li>• Kërcimi teatral në Itali dhe Francë.</li> <li>• Pierre Beauchamps, risitë e tij në balet.</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Shekulli XVIII</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ramo dhe akademizmi i baletit</li> <li>• Reformat e Hilverding në Vienë</li> <li>• Reformat e Jean-Georges Noverre</li> <li>• Reformat e Gasparo Angiolini</li> <li>• Jean Dauberval. Baletet e tij</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Epoka e Noverit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Debati estetik. Kërcimi si një art imitimi.</li> <li>• Reformat e Jean – Georges Noverre.</li> </ul>
--	--	--	--

			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Baletet dhe bashkëpunëtorët e Noverit.</li> <li>• Reforma e Gasparo Angiolini. Baletet e tij.</li> <li>• Polemikë midis Angiolinit dhe Nover.</li> <li>• Evolimi i teknikës Akadematike franceze.</li> <li>• Reforma e dytë në baletin francez. Jean Dauberval.</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Baleti pre-romantik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Karlo Blasis, teoricien i baletit pre – romantik</li> <li>• Koreodrama e Salvatore Vigano. Baletet e tij.</li> <li>• Charl Lui Didlo dhe baletet e tij pre – romantike</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Baleti Romantik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koreografët, kompozitorët dhe balerinët e romantizmit</li> <li>• Baletet romantike. Veçoritë e tyre.</li> <li>• Analizë baletet Silfide, Zhizel, Korsar</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Baleti europian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX dhe Baletit rus në shekullin e XIX</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Baletit Francez, Anglez, Italian dhe Danez</li> <li>• Charl Didlo në formimin e teatrit të baletit rus. Romantizmi në baletin rus</li> </ul>
--	--	--	---

			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Artur Sen – Leon dhe reformimi i baletit rus.</li> <li>• Marius Petipa dhe teatri i baletit në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. baletet e tij.</li> <li>• Lindja e baletit simfonik.</li> <li>• Liqeni i Mjelmave, Rajmonda, Arrëthyesi, Bija e Faraonit, Bukuroshja e fjetur.</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Ritmi dhe plasika e kërcimit në fillim të shekullit të XX. Sezonet Ruse</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërcimi i lirë. Forma estetike e tij. Pionerët Amerikanë të kërcimit të lirë: Loie Fuller, Ruth St. Denis, Isadora Duncan</li> <li>• Kërcimi i lirë European: Emile Jaques – Dalcroze, Rudolf Laban</li> <li>• Kërcimi ekspresionit gjerman: Mary Wigman, Kurt Joos</li> <li>• Sezonet ruse dhe S. Djailjev. Koreografët dhe artistët e sezoneve ruse</li> <li>• Michael Fokin</li> <li>• Ana Pavlova</li> <li>• George Balanchine</li> </ul> <p style="text-align: center;"><b>Baleti në Europë, Amerikë dhe ish BRSS në shekullin e XX .</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Forma e reja të kërcimit akademik</li> <li>• Tiparet e koreografisë sovjetike mbas revolucionit deri në vitet '90</li> </ul>
--	--	--	---

			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Agripina Vaganova dhe metoda Vaganova</li> </ul> <p><b>Kërcimi modern shekulli XX</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërcimi modern në Amerikë: Martha Graham, Jose Limon, Doris Humphrey. Kërcimi xhaz dhe pionierët e tij në amerikë</li> <li>• Avangardët e rinj ammerikanë: Ann Halprin, Merce Cunningham, Murray Louis</li> </ul> <p><b>Kërcimi kontemporanë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërcimi post modern. Dance teatër. Pina Bausch.</li> <li>• Kërcimi i ri në Angli dhe Francë</li> </ul>
--	--	--	--

## TABELAT E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënit që duhet të demonstrojë nxënësi për të përmbushur dhe demonstruar njohuritë artistike në lëndën me zgjedhje histori baleti. Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.

### TEMATIKA: Folklor koreografik

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike
<p><b>Karakteristikat e përgjithshme të lirikës në koreografi</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- argumenton <i>ndarjen etno-koreografike</i>;</li> <li>- gjykon mbi <i>shtrirjen dhe karakteristikat e çdo treve</i>;</li> <li>- përcakton <i>temat kryesore të lirikës</i>;</li> <li>- argumenton <i>temën e punës dhe temën e dashurisë</i>;</li> <li>- gjykon mbi <i>komiken, ritualen dhe elegjiaken</i>;</li> <li>- përcakton <i>specifikën e valles</i>;</li> <li>- argumenton mbi <i>faktorët e brendshëm të valles</i>;</li> <li>- përcakton <i>numrin e strukturave të kërcimit</i>;</li>   <li>- argumenton <i>strukturën e trehapshit asimetric dhe pesëhapshit asimetric</i>;</li> <li>- përcakton <i>strukturën e dyhapshit të vazhdueshëm dhe trehapshit</i>;</li> <li>- përcakton <i>format e kërcimit popullor</i>;</li> <li>- argumenton <i>kërcimin në rreth të mbyllur, formën zinxhir, formën spiral dhe kërcimin solistik</i>;</li> <li>- përcakton <i>llojet e shoqërimit muzikor të valles popullore</i>;</li> <li>- argumenton <i>vallet e heshtura dhe të kënduara</i>;</li> <li>- analizon <i>shoqërimin instrumental dhe vallen e gjatë</i>.</li> </ul>
<p><b>Epika në koreografi</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon <i>epikën në vallet shqiptare</i>;</li> <li>- përcakton <i>rëndësinë dhe përmbajtjen e epikës në</i></li> </ul>

	<p>koreografi;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- analizon <i>vallet e rënda, vallet dyshe dhe treshe</i> karakterin dhe rëndësinë e tyre.</li></ul>
--	---

**TEMATIKA: Histori e baletit shqiptar**

<b>Njohuritë artistike</b>	<b>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike</b>
<b>Baleti në gjysmën e parë të shekullit XX</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- njihet me grupet e para të baletit mbas luftës;</li><li>- përshkruan kërcimet e para koreografike dhe aktivitetet në të cilat morën pjesë këto grupe kërcimi;</li><li>- njihet me krijimin dhe rëndësinë historike të krijimit të filarmonisë.</li><li>- argumenton mbi aktivitetet artistike të Filarmonisë;</li><li>- analizon “Vëllazërimi i popujve”, spektakli i parë koreografik në Shqipëri.</li></ul>
<b>Krijimi i Teatrit të Operas dhe Baletit</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- njihet me krijimin e TOB dhe AKVP;</li><li>- shpjegon grupin e të 5-ve. Artistë dhe themeluesit e shkollës së baletit;</li><li>- argumenton mbi rëndësinë dhe rolin që luajtën grupi i të pestëve në ngritjen profesionale të trupës së baletit;</li><li>- përshkruan jetën dhe veprimtarinë artistike të koreografit Skënder Selimi “Fadeta”, “Laurencia” dhe “Shehrezade”;</li><li>- përshkruan jetën dhe veprimtarinë artistike të koreografit P.Kanaci dhe analizon baletin e parë shqiptar “Halili dhe Hajria”;</li><li>- përcakton grupin e të pestëve dhe argumenton rolin e tyre në hapjen e shkollës së baletit;</li><li>- përshkruan jetën dhe veprimtarinë artistike të koreografit Agron Aliaj dhe përcakton tematikën, autorët dhe personazhet e baletit “Cuca e Maleve”;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"><li>- përcakton <i>saktë</i> baletet me temë historike, baletet me temë shoqërore, baletet me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare, baletet me temë bashkëkohore, baletet me temë përralle;</li><li>- analizon veprat e vëna në skenë nga koreografi Agron Aliaj mbas viteve '90;</li><li>- identifikon veprat dhe koreografët mbas viteve '90.</li></ul>
--	--



**TEMATIKA: Histori e baletit botëror**

<b>Njohuritë artistike</b>	<b>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave artistike</b>
<b>Kërcimi në lashtësi dhe antikitetet</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>- përcakton burimet materiale;</li><li>- argumenton në sa forma i gjejmë dhe nxjerr në pah rëndësinë e tyre;</li><li>- përcakton elementet themelore të kërcimit;</li><li>- argumenton mbi rëndësinë e hapësirës, kohës forcës dhe marrëdhënies në kërcim;</li><li>- argumenton mbi përhapjen e kërcimit në lashtësi;</li><li>- evidenton karakteristikat e kërcimit në Egjypt dhe në Lindjen e largët;</li><li>- përcakton llojet e kërcimit në Greqi;</li><li>- analizon kërcimet e shenjta, gjykon mbi rëndësinë e kërcimeve luftarake, vë në pah karakteristikat e kërcimeve skenike dhe kërcimeve popullore;</li><li>- përcakton llojet e kërcimeve në Romën antike.</li></ul>
<b>Mesjeta dhe llojet e kërcimeve</b> <b>Rilindja</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>- përcakton dhe kërcimet popullore të periudhës;</li><li>- argumenton teknikat dhe shoqërimin muzikor përgjatë mesjetës;</li><li>- shpjegon zhvillimin e kërcimit në periudhën e Rilindjes;</li><li>- argumenton rolin e kërcimit në periudhën e rilindjes;</li><li>- shpjegon karakteristikat e kërcimeve të ulëta, të larta;</li><li>- shpjegon çfarë janë maskat dhe antimaskat.</li></ul>
<b>Kërcimi në shekullin XVII</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>- përcakton rëndësinë që melodrama i dha kërcimit;</li><li>- përcakton rëndësinë që mori kërcimi në periudhën e mbretit Luigji XIV;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- evidenton koreografët me të cilët bashkëpunoi mbreti;</li> <li>- përcakton qëllimet e hapjes së Akademisë Mbretërore të kërcimit;</li> <li>- argumenton studimet me të cilat u mor dhe zhvilloi Akademia;</li> <li>- përcakton rëndësinë e hapjes së Akademisë;</li> <li>- Shpjegon tiparet e spektakleve të Luli dhe Molier.</li> </ul>
<b>Kërcimi në shekullin XVIII</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton rëndësinë e Rameau për operan franceze;</li> <li>- shpjegon karakteristikat që përmban opera-balet e Rameau;</li> <li>- përcakton rëndësinë e baletëve të Hilverding dhe analizon tri tipologjitë e baletëve;</li> <li>- përcakton reformat e Noverre;</li> <li>- argumenton rëndësinë e baletit si gjini teatrale;</li> <li>- analizon filozofinë e balet d'action të Noverre;</li> <li>- përcakton reformat e Gasparo Angiolini;</li> <li>- analizon veprimtarinë artistike të Jean Dauberval;</li> <li>- shpjegon baletet e Jean Dauberval;</li> </ul>
<b>Baleti pre-romantik</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon çfarë janë baletet pre – romantike;</li> <li>- analizon veprat pre – romantike dhe teoritë e Karlo Blasis;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë e Salvatore Viganò dhe risitë e tij në artin e baletit;</li> <li>- shpjegon çfarë është koreodrama dhe baletet që i përkasin kësaj rryme;</li> <li>- analizon veprimtarinë artistike të Sharl Lui Didlo në periudhën e pre – romantizmit;</li> <li>- shpjegon baletet e Sharl Lui Didlo pre – romantike.</li> </ul>
<b>Baleti Romantik</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon stilin e kërcimit të kësaj periudhe;</li> <li>- përshkruan leksikun e përdorur dhe aftësitë plastike të kërcimtarëve të kësaj periudhe;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon rëndësinë e kërcimit në majë të gishtave (puante);</li> <li>- përshkruan strukturën e baletëve të romantizmit;</li> <li>- njih koreografët dhe balerinët më të rëndësishëm të periudhës;</li> <li>- shpjegon baletet më të njohura të romantizmit dhe kompozitorët e tyre (zhizel, silfidë, korsar).</li> </ul>
<p><b>Baleti europian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX dhe Baleti rus në shekullin e XIX</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan zhvillimin e baletit në Francez, Anglez, Danez dhe Italian;</li> <li>- shpjegon veprimtarinë e Charl Didlo dhe rëndësinë e tij për formimin e teatrit të baletit Rus;</li> <li>- përshkruan baletet e tij në këtë fazë;</li> <li>- shpjegon veprimtarinë e Artur Sen – Leon dhe rëndësinë e tij për reformimin e teatrit të baletit Rus;</li> <li>- analizon baletet kryesore të këtij koreografi në këtë periudhë;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë e Marius Petipa dhe zhvillimin që mori baleti rus gjatë periudhës artistike të tij;</li> <li>- analizon baletet kryesore të Marius Petipa ( e bija e faraonit, Rajmonda dhe baletet simfonike);</li> <li>- shpjegon baletet simfonike dhe kush janë krijuesit e këtij baletit.( Çajkovskij);</li> <li>- analizon baletet simfonike kryesore (Arrëthyesi, Bukuroshja e fjetur, Liqeni I Mjelmave ).</li> </ul>
<p><b>Ritmi dhe plasika e kërcimit në fillim të shekullit të XX</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon çfarë forme estetike ka kërcimi i lirë dhe kush janë pionerët e këtij kërcimi;</li> <li>- shpjegon zhvillimin e kërcimit të lirë;</li> <li>- analizon veprimtarinë e amerikanëve Loie Fuller, Ruth St. Denis,Isadora Dulkan;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë e kërcimit të lirë europian;</li> </ul>

<p><b>Sezonet Ruse</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon veprimtarinë e Emile Jaques – Dalcroze dhe Rudolf Laban;</li> <li>- shpjegon çfarë është kërcimi ekspresionit;</li> <li>- analizon veprimtarinë e Mary Wigman, Kurt Joos;</li> <li>- shpjegon rrethanat e krijimit të kërcimit të lirë dhe atij ekspresionist;</li> <li>- shpjegon rëndësinë e sezoneve ruse në baletin botëror;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë e koreografëve, kërcimtarëve më të njohur të sezoneve ruse. Michael Fokin, Ana Pavllova, George Balanchin, Sergei Lifar, Vaslav Nijinski;</li> <li>- analizon baletet më të suksesshëm të sezoneve ruse;</li> <li>- shpjegon ndryshimet që pësoi arti koreografik dhe teknika e tij në sezonet ruse.</li> </ul>
<p><b>Baleti në Europë, Amerikë dhe ish BRSS në shekullin e XX</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon format e reja të kërcimit akademik në Europë, Amerikë dhe BRSS;</li> <li>- shpjegon zhvillimin e baletit europian dhe atij amerikan në shekullin XX;</li> <li>- analizon koreografët më të rëndësishëm të kësaj periudhe;</li> <li>- shpjegon format e baletit sovjetik dhe mënyrën e ndërtimit të tyre;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë e koreografëve më të njohur të baletit sovjetik dhe baletet e tyre;</li> <li>- Agripina Vaganova dhe metoda Vaganova.</li> </ul>
<p><b>Kërcimi modern shekulli XX</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon rrethanat e krijimit të baletit modern në botë dhe nënndarjet e tij;</li> <li>- tregon zhvillimin e kërcimit modern dhe format e tij;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë dhe veprat kryesore të Martha Graham, Jose Limo, Doris Humphrey;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon kërcimin xhaz dhe veprimtarinë e pionerëve të këtij kërcimi;</li> <li>- përshkruan veprimtarinë dhe veprat kryesore të avangardëve të rinj amerikanë Ann Halprin, Merce Cunningham, Murray Louis.</li> </ul>
<b>Kërcimi kontemporan</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon zhvillimin e kërcimit postmodern, danc teatrit dhe kërcimin e ri;</li> <li>- përshkruan veprimtarin e Pina Bausch dhe veprat e saj kryesore;</li> <li>- analizon kërcimin e ri në Angli dhe Francë.</li> </ul>